

Ku paraqitet kërkesa për informim?

Gjykata vihet në lëvizje me anë të kërkesës me shkrim, që mund të paraqitet dorazi, me postë në adresën: Rruga "Jordan Misja", 1057, Tiranë, ose me postë elektronike në adresën zyrtare të Email-it të specialistit të Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, Sektori i Teknologjisë së Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Median dhe me Jashtë, elsa.lita@gjykata.gov.al.

Individi i cili dëshiron ta paraqesë kërkesën dorazi, mund të paraqitet në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në Zyrën e Protokoll/Arkivë-s, çdo ditë pune, nga ora 08:00-16:00.

A ka një model për hartimin e kërkesës për informim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar? Nëse po, ku mund ta gjej atë?

Po, në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar www.gjp.gov.al gjendet formulari tip për paraqitjen e kërkesës, konkretisht në linkun e mëposhtëm:

https://www.gjp.gov.al/rc/doc/Formular_Kerkese_per_Informacion_5094.pdf